



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 3/6 Prot

Vlorë, më 17. 02. 2023.

VENDIM

Nr. 1 , datë 09.02.2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR UJITJE, TË P.F “JONA ÇELA”, ME VENDNDODHJE: KUÇ,
BASHKIA HIMARË, QARKU VJORË**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të P.F “Jona Çela”, “Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujitje (në rastin kur përdorimi është për ≤ 5 ha, ≤ 5 l/sek)”, me vendndodhje: Kuç, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Kuarternar

Koordinatat e vendndodhjes së burimit (KRGJSH)

X= 485384.9

Y=4449242.6

Z= 371.8 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: Q=0.4 l/sek

Sipërfaqja e parcelës që do të ujjitet: S=1.015 ha

Periudha e përdorimit të ujit: Qershor-Korrik-Gusht-Shtator-Tetor

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

Pika 1 X= 485402.1; Y= 4449260.4; Z= 372 m.m.n.d

Pika 2 X= 485447.9; Y= 4449217.2; Z= 374 m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

X= 485370.2; Y= 4449281.8; Z=369.5 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: 0.0176 l/s.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

K R Y E T A R

FLAMUR MAMAJ



Flamur Mamaj